

---

**Lënda:** Informacion i pjesshëm në lidhje me inspektimin e objektëve të finacuara nga Bashkia Tiranë për periudhën kohore nga viti 2012 deri në vitin 2018.

**Objekti:** Ndërtimi rrugës "Gramoz Pashko", Tiranë

**Investitori:** Bashkia Tiranë

**Vlera e Investimit:** 83,460,867 leke +16,152,605 leke shtese kontratë për objektin

**periudha kohore:** Korrik 2012 deri në Nëntor 2013

**Inspektimi është kryer:** Dhjetor 2018

Ky objekt është zbatuar në qytetin e Tiranës në një segment të ri rrugor, pozicionuar në anën Jug Lindore të zonës së Qytetit Studenti. Segmenti rrugor nis nga bashkimi i rrugës "Gramoz Pashko", me rrugën "Maksim Artioti" dhe përfundon në fundin e kesaj rrugë pak më sipër me kryqëzimin e kësaj rruge me rrugën "Dajti", me një gjatësi të përgjithshme rreth 300 m. Në momentin e investimit në këtë segment rrugor nuk ka qenë investuar më pare. Ka patur vetëm kalim traseje të saj (nga vetë banorët e ndërtimeve në zonë) dhe ndërhyrja është bërë për ndërtim e rrugës të re, me të gjitha komponentët e saj.

Projekti ka ndërhyre në ndërtimin e shtresave rrugore të trupit të rrugës (shtrimi me bindër dhe shtrimin me asfalt), në ndërtimin e plotë të nënshtresave të trupit të rrugës me të gjitha komponentët e saj (stabilizanti, plus nënshtresat e tjera), në ndërtimin e rrjetit të ujrave të bardha dhe të zeza, në ndërtimin e tubacionit të ujit të pijshëm, në ndërtimin e plotë të trotuareve, plus rrjetin e ndriçimit, në sinjalistikë rrugore, gjelbërim, etj. Projekti zbatimit ka parashikuar ndërtim të plotë të këtij segmenti rrugor. Punimet kanë filluar rreth muajit Korrik të vitit 2012, e kanë përfunduar në muajin Dhjetor 2013. Zona ka filluar të ndërtohet kryesisht pas viteve 2000 dhe përfundimi i këtij segmenti rrugor ka qenë shumë i rëndësishëm për banorët e të gjithë zonës. Afati i garancisë së punimeve për objektin tashmë ka përfunduar (afati për këtë objekt ka qenë dy vite). është kryer në favor të firmës zbatuese të punimeve edhe zhbllokimi i Garancisë së Punimeve prej 5 % të vlerës së situacionit. Zbatimi i punimeve është bërë në kushte optimale, pasi pothuajse gjatë kohës së zbatimit të punimeve e gjithë rruga ka qenë e bllokuar për kalimin e mjeteve motorike. Edhe pse objekti ka disa vite që është përfunduar cilësia e zërave kryesorë të punimeve është në nivele të kënaqëshme (të kalueshme). Sipas manualit të punimeve të ndërtimeve edhe pse garancia e punimeve zgjat vetëm dy vite, jetgjatësia e ketyre investimeve do duhet të shkojë për një periudhë kohore prej 7 deri në 10 vjet.

---

### Nga pamja vizuale e objektit konstatojmë se:

- Trupi i rrugës nuk rezulton të ketë ulje edhe pse vihen re në disa sektorë të rrugës disa plasaritje të shtresave të asfaltit, por pa problematika të theksuara,
- Plakat e trotuareve kanë disa ulje të vogla,
- Gjerësia e trotuareve nuk është e njëtrajtshme në të gjithë gjatësinë e rrugës,
- Vihen re thyerje e plasaritje të pllakave të trotuareve,
- Nuk janë respektuar sipas standardit të kërkuar lidhja e trotuareve me trupin e rrugës për personat me aftësi të kufizuar (në disa segmente ato pothuajse mungojnë fare).



Fig 1  
Pusetat janë vendosur në nivel të njëtrajtshëm me trupin e rrugës (me parete anesore të tyre të qendrueshme dhe shumica prej tyre ane të pa levizshme),



Objekti ka patur shtesë punimesh gjatë zbatimit të tij në shumën 20% të vlerës së kontratës fillesatare të zbatimit. Kjo tregon se projekti i plotë i zbatimit për këtë objekt, nuk është hartuar konform standardeve të kërkuara, e më së pakti është hartuar nga zyra, pa e prekur në vend të gjithë objektin që do të ndërtohet. Edhe pse segmenti rrugorë ka një gjatësi shumë të vogël shtesa e punimeve prej 20 % mendoj se nuk është e justifikuar.

Fig 2

Nje disa segmente te kunetave anesore prej betoni vihen re disa plasaritje te vogla (kryesisht pjesa e lidhjes se tyre me hapesirat e parkimit anes rruges

Bashkia Tiranë si Investitore e këtij objekti, ka përdorur të gjitha atributet ligjore për shtësen e punimeve për këtë objekt. Ligji lejon shtesë për punime të paparashikuara, jo më shumë se 20 % të vlerës së kontratës. Në rastin konkret jemi në vlerën e shtesës fiks sa 20% të kontratës fillestare.

### **Konkluzione në lidhje me objektin.**

- *Të bëhet riparimi i pllakave të parapërgatitura të trotuareve, duke zëvendësuar të gjitha pllakat e thyera apo dëmtuara në to.*
- *Të ribëhen dhe riparohen të gjitha kalimet për personat me aftësi të kufizuar të trotuareve, me lidhje të njëtrajtëshme me trupin e rrugës, e pa pengesa.*
- *Nga kontrolli i lartë i shtetit do duhen të shikohen dhe kontrollohen me rigorozitet të gjitha shtesat e kontratave të punimeve të zbatimit, duke evidentuar me argumenta bindës se kush është qëllimi i vërtet i këtyre shtesave të punimeve. Mbi projektuesin e rrugës do duhet të kishte patjetër përgjegjesi, me se pakti për neglizhence në hartimin e projektit të zbatimit të punimeve për këtë objekt.*

- 
- *Sipas mendimit tonë objekti i ka rezistuar afatit kohor të ndërtimi të tij dhe se riparimet për përmirësimin e kesaj rruge janë shumë të vogla. Kjo edhe për faktin e kalimit të një periudhe nga përfundimi i objektit në rreth 5 vjet.*

Për të gjitha vërejtjet e mësipërme jemi mbështetur në nenet e praktikave standarde të kontratave të zbatimit të punimeve, si dhe në Udhëzimin e Keshillit të Ministrave Nr 3, Datë 15.01.2001, Nr 2, datë 13.05.2005 dhe Nr 1, datë 16.06.2011, "Për mbikqyrjen dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit".